

Siguri

Ahengu familjar në Podujevë shoqërohet me të shtëna – 32-vjeçari pranon para Policisë se shtiu, gjenden 12 gëzhoja



Sinjali.com

10 Gusht 2026 09:23



Një aheng familjar në fshatin Bellopojë të Podujevës është shoqëruar me të shtëna mbrëmjen e së dielës, duke bërë që Policia të intervenojë në vendin e ngjarjes.

Sinjali mëson se i dyshuari është Faton Matarova 32-vjeçari, i cili ka pranuar para zyrtarëve policorë se kishte shtënë me armë me gaz gjatë ahengut.

Rasti është raportuar më 9 gusht, rreth orës 22:00, kur Policia ka marrë informatën për të shtëna në fshatin Bellopojë.

Njësitë policore kanë dalë në lokacion dhe, pas konsultimit me Prokurorin kujdestar, janë autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, Matarova u ka deklaruar policëve se kishte shtënë gjatë një ahengu familjar me një armë me gaz.

Në vendin e ngjarjes janë gjetur 12 gëzhoja, të cilat dyshohet se janë shkrepur nga arma me gaz.

32-vjeçari është shoqëruar dhe intervistuar në cilësinë e të dyshuarit, ndërsa pas përfundimit të procedurave është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti është iniciuar për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës” dhe “Përdorim të a*mës apo mjetit të rrezikshëm”.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Aheng

familjar

Polici

Të tjera:



Arrijnë në Prishtinë veturat e reja të Policisë së Kosovës

Kosovë



Jeton Mushkolaj: Kosova humbi një polic shembullor, Selim Sutaj la pas një trashëgimi t...

Kosovë



Ekskluzive | Shtiu me armë në aheng në Han të Elezit, 22-vjeçari paraqitet vetë në Polici...

Sinjalizime




Vëllai i policit Shaban Hajdari me fjalë rrëqethëse: “Ah bre Shaban”

Kosovë



“Kujtimet do të mbeten të gjalla gjithmonë për ty”, mësuesja me dedikim prekës për...

Kosovë



Reagon shoku i policit të ndjerë: Humbëm një shok të mirë, një njeri me vlera dhe një polic të...

Kosovë



Ky është polici i Kosovës që u gjet i vdekur në Morinë

Siguri



E dashura e denoncoi se e rrihte, 27-vjeçari përfundon në Polici për dhunë në familje

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera